

## KUSHTE PUNE @BANKING

### FUNKSIONALITETET E OFRUARA JANË:

1. Akses i sigurisë së lartë të llogarive dhe transaksioneve
2. Pasqyra e llogarive (llogarisë rrjedhëse, të kursimit dhe depozitës me afat),
3. Shikim i gjendjes në llogaritë e autorizuara – që ju tregon gjendjen momentale në llogarinë tuaj,
4. Shikim i transaksioneve në të gjitha llogaritë e autorizuara,
5. Shikim i shkurtër i lëvizjeve (lista e transaksioneve) – që ju tregon transaksionet e bëra në llogarinë tuaj (hyrje/dalje),
6. Përgatitja dhe dërgimi i urdhërpagesave midis llogarive personale,
7. Përgatitja dhe dërgimi i urdhërpagesave brenda vendit (jashtë Banke në Lek dhe Brenda Bankës për çdo monedhë)\*,
8. Përgatitja dhe dërgimi i urdhërpagesave në favor të kompanive utilitare\*,
9. Përgatitja dhe dërgimi i urdhërave brenda Bankës për llogaritë e të njëjtit klient\*,
10. Përgatitja dhe dërgimi i urdhërpagesave në favor të Zyrës së Taksave\*,
11. Përgatitja dhe dërgimi i urdhërpagesave në monedhë të huaj\*,
12. Forma e pagesës Brenda vendit – është një përmbledhje e urdhërpagesave të cilat ju mund t'i përdorni më shpesh për një përfitues të caktuar;
13. Forma e pagesës Jashtë vendit – është një përmbledhje e urdhërpagesave të cilat ju mund t'i përdorni më shpesh për një përfitues të caktuar;
14. Shikim i përfituesve të përcaktuar Brenda vendit\* – listohen përfituesit të cilët ju mund të keni fluksin më të madh të urdhërpagesave, përfituesit më të përdorshëm nga ju,
15. Shikim i përfituesve të përcaktuar jashtë vendit\* – listohen përfituesit të cilët ju mund të keni fluksin më të madh të urdhërpagesave, përfituesit më të përdorshëm nga ju,
16. Shtim i përfituesve të përcaktuar nëpërmjet kodit të dërguar me mesazh në celularin e klientit.
17. Përgatitja e mesazheve - përdoruesi i kërkon informacion Bankës,
18. Marrja e mesazheve nga Banka - Banka dërgon përgjigjen e pyetjes ose mesazhit,
19. Dërgimi i mesazheve,
20. Arkiva e pagesave Brenda vendit – ku arkivohen të gjitha urdhërpagesat e bëra nga ju nëpërmjet @-banking,
21. Arkiva e pagesave Jashtë vendit – ku arkivohen të gjitha urdhërpagesat e bëra nga ju nëpërmjet @-banking.

\*) Përfituesit janë të përcaktuar vetëm për përdoruesit me "Emër përdoruesi" dhe "Fjalëkalim"

### ORARI I PUNËS NË @-BANKING

@-banking aksesohet gjatë 24 orëve të ditës, 7 ditë të javës, ndërsa transaksione mund të kryhen vetëm në orarin 9:00 – 15:15. **Banka rezervon të drejtën të kërkojë informacione më të detajuara/dokumenta shtesë në rast nevojë të cilat klienti duhet të paraqesë. Klienti do të informohet për paraqitjen e këtyre dokumentave nga stafi i Bankës.** Për transfertat jashtë vendit si dhe për tatimet me deklaram do të paraqesë në BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA brenda orës 15:15 të së njëjtës ditë në të cilën kryehen transaksionet me Internet Banking, dokumentat mbështetëse për secilin prej këtyre veprimeve.

**Nëse këto dokumenta nuk do të paraqiten në Bankë sipas afatit kohor të sipërpërmendur, atëherë Banka rezervon të drejtën të refuzojë urdhërin e dhënë nga Unë (Mbajtësi) duke mos kryer transaksionin nëpërmjet Internet Banking.**

### LIMITET

Vlera maksimale e pagesave që do të kryhen nëpërmjet @-Banking (limitet për transaksion):

« Vlera maksimale për pagesa të individëve (transferta personale): EUR 3,000 ekuiv

« Vlera maksimale për pagesa ndaj Klientëve biznes (transferta biznesi): ALL 2.8MIO (EUR 20,000 ekuiv).